

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut,nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën Bujqësore dhe ate Komerciale, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Beshir Islami kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Nebojša Boričić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

H. Q. nga Prishtina , ushtruar për mes të autorizuarit avokat B. Sh. nga Prishtina,
Kundër:

Z. G., me vendbanim në Mitrovicë, të cilin sipas Autorizimit e përfaqëson, avokat **Z. B., nga Prishtina, ...**
Palë përgjegjëse në ankesë,

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, (KKPK), nr. KPCC/D/R/263/2014, të datës 21 Tetor 2014,(lënda e regjistruar në AKP me numër KPA01404), pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë, 21 Mars 2019, merr;

AKTGJYKIM

1. **Aprovohet ankesa e paraqitur nga H. Q., kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës,(KKPK),nr. KPCC/D/R/263/2014, të datës 21 Tetor 2014, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP me numër KPA01404.**
2. **Prisheet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/263/2014, i datës, 21 Tetor 2014, për sa i takon kërkesës së regjistruar në AKP, me numër KPA01404.**
3. **Bazuar në nenin 198.1 të Ligjit Nr.03/L006, të Procedurës Kontestimore, kërkesa e H. Q., e paraqitur në AKP, me numër, KPA01404, hedhet poshtë, për shkak të mungesës së juridiksionit të KKPK-së.**

Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale;

1. Me datë, 05/12/2007, H. Q. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP), me të cilën kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore si pronar, dhe të drejtën e shfrytëzimit të banesës e cila gjendet në Prishtinë, ..., në sipërfaqe prej 53,85 m². Sipas palës ankuese, banesa lëndore atij i është ndarë nga Drejtori i Korporatës Energjetike të Kosovës, (tutje KEK), në vitin 1980. E njëjta në vitin 1986 i ishte ndarë një punëtori tjetër dhe pasi që ai e ka lënë punën dhe banesën në vitin 1992, përsëri është lejuar të vendoset në këtë banesë, në bazë të marrëveshjes së lidhur me Drejtorin e KEK-ut. I njëjti deklaroi se në këtë banesë ka jetuar deri në kohën kur është zhvendosur për shkak të konfliktit të viteve 1998/99 dhe pastaj ka vazhduar të jetoj në këtë banesë deri sa është dëbuar nga KPA në vitin 2012.

2. Në mbështetje të kërkesës së tij, pala ankuese, kishte dorëzuar në AKP dokumentet vijuese;
 - Njoftimin e lëshuar nga KEK-u, për Drejtorin për Çështje Pronësore Banesore, lidhur me përshkrimin e ecurisë së shfrytëzimit të pronës lëndore nga pala ankuese .
 - Një kontratë për shfrytëzimin e pronës së kërkuar nga pala e tretë (Xh. I.), ... të lidhur me Ndërmarrjen Publike Banesore.
 - Vendimin për ndarjen në shfrytëzim të banesës, nr. ..., të dt. ..., me të cilin KEK-u, ia ndanë në shfrytëzim në kohë të pa caktuar palës ankuese pronën e kërkuar, me të cilën obligohet që të lidhë kontratë shfrytëzimi me ndërmarrjen banesore.
 - Vendimin për ndarjen e banesës nr. ..., dt. 05.09.1995, me të cilin KEK-u i ndan palës përgjegjëse një banesë tjetër në periudhë të caktuar kohore në rr. ... në Prishtinë.
 - Faturë të Energjisë Elektrike të vitit 1998, që tregon se pala ankuese e kishte shfrytëzuar banesën e kërkuar para periudhës së viteve, 1998/99.
 - Faturë nga Ujësjellësi, nr. ..., të dt. 31.09.1998, për pagesën e shpenzimeve të ujit, e cila po ashtu dëshmon se prona e kërkuar është shfrytëzuar nga ky.
 - Kontratë Qiraje, nr. ..., e dt. 09.02.1999, të bërë ndërmjet Ndërmarrjes Publike Banesore si qiradhënës dhe palës përgjegjëse, si qiramarrës i pronës së kërkuar.
 - Kontratë shitblerje nr. i evid. gjyqësore .../..., e dt. 19.03.1999. 25.02.1999, të bërë në mes të KEK si shitës dhe palës përgjegjëse si blerës (ishte palë kërkuese në HPD).
 - Vendimin, nr. ..., të dt. 29.01. 2007, lëshuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë sipas padisë së palës ankuese kundër palës përgjegjëse dhe KEK, me të cilin Vendim gjykata ka vendosur masën e përkohshme, ndalimin e shitjes së kësaj prone deri sa të përfundoj procedura gjyqësore sipas padisë.
 - Propozimin e KEK-ut, nr. ... E ..., dt. 08.03.2007, me të cilin i propozohet gjykatës për ndalimin e shitjes së pronës së kërkuar.
 - Vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr. 1637/07, dt. 30.05.2012, me të cilin gjykata shpallet jo kompetente për të vendosur sipas padisë së palës ankuese lidhur

me pronën e kërkuar, pasi që kjo lëndë ka qen dhe është vendosur me Vendim përfundimtar të Drejtorisë për Çështje Banesore Pronësore(DÇPB), në vitin 2006.

3. Me datë 04 Shkurt 2008, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte bërë notifikimin e pronës së kërkuar e cila në momentin e vizitës rezultoi se ishte duke u shfrytëzuar si apartament banimi nga pala ankuese H. Q.. I Njëjti kishte kërkuar të drejtë ligjore në këtë pronë dhe ka nënshkruar Njoftimin e pjesëmarrjes. Po ashtu sekretaria kishte vërtetuar faktin se i njëjti kishte qen palë përgjegjëse në kërkesën e më hershme në Drejtorin për Çështje Banesore dhe Pronësore, në mes tij dhe palës përgjegjëse, Z. G. dhe ishte vërtetuar se pas Vendimit të HPCC, tani pala ankuese H. Q. kishte hyrë në skemën e qirasë për shfrytëzimin e kësaj banese, ndërsa në vitin 2012 i njëjti ishte dëbuar nga banesa lëndore.
4. Z. G. palë përgjegjëse në kërkesën e palës ankuese, për mes autorizimit e ka autorizuar avokat Z. K. që të paraqitet në emër të tij, i njëjti pretendon të drejtë ligjore në pronën e kërkuar, dhe deklaron se; prona lëndore i ishte ndarë në mënyrë të ligjshme, në te ka banuar prej muajit Dhjetor 1998, deri në Qershor 1999, kur ishte zhvendosur për shkak të konfliktit. Andaj propozon që kërkesa e tani palës ankuese të hedhet poshtë si e pa pranueshme ,me që i njëjti kishte qen palë në DÇPB(HPD), dhe me Vendimin e HPCC të nxjerrë sipas ankesës së tij, për rishqyrtim të datës 18.10.2006 ,ankesa e tij ishte refuzuar,(i cili Vendim ishte i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm, sipas Rregullores së UNMIK 1999/23, dhe nuk i nënshtrohet asnjë autoriteti për shqyrtim qoftë gjyqësor apo administrativ).
5. Në mbështetje të drejtës së tij, i autorizuari i palës përgjegjëse në ankesë ,në mes tjerash paraqet dokumentet si në vijim;
 - Një përlllogaritje të vitit 2012 sipas të cilit pala përgjegjëse Z. G., kishte kërkuar nga KEK-u, të caktoj çmimin e shitblerjes për banesën lëndore sipas Ligjit nr. 04/L-061, në mënyrë që pala përgjegjëse ta blejë banesën.
 - Një përgjigje të KEK-ut për palën përgjegjëse të vitit 2012 ,sipas së cilës palës përgjegjëse i lejohet blerja e banesës lëndore.
6. Sipas Raportit të Verifikimit të Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së, Vendimi për ndarjen në shfrytëzim të banesës, nr. , të dt. 10.03.1992, me të cilin KEK-u, i ndanë në shfrytëzim në kohë të pa caktuar palës ankuese pronën e kërkuar, është verifikuar negativisht. Po ashtu Kontratat për shitblerje të banesës të paraqitura nga pala përgjegjëse të datave 19.03.1999, dhe 25.02.1999, se kinse pronën e ka blerë nga KEK-u, janë verifikuar negativisht.
7. Gjatë kontaktit me palët nga sekretaria e AKP-së, pala ankuese ka deklaruar se nuk posedon dokumente të cilat e dëshmojnë të drejtën pronësore të tij për të fuqizuar kërkesën e tij, ndërsa dokumentet e paraqitura nga pala përgjegjëse si Kontrata nr. ..., e dt. 09.02.1999, dhe kontrata e blerjes së banesës, pala ankuese i ka atakuar si të falsifikuara nga pushteti i

atëherëshëm. I Autorizuari i palës përgjegjëse ka deklaruar se pala përgjegjëse nuk i ka përfunduar procedurat

e privatizimit për banesën e kërkuar edhe pse është pronar i ligjshëm ndërsa pohon se kanë ushtruar një padi ndaj palës ankuese për falsifikim të një vendimi për ndarje të banesës.

8. KEK-u në përgjigjen e dhënë me shkrim të dt. 11.10.2006, konfirmon se është pronar ligjor i pronës lëndore, se kjo pronë i ishte ndarë palës përgjegjëse Z. G. por se e njëjta nuk i është shitur, sepse i njëjti e kishte edhe një banesë tjetër të ndarë nga KEK, andaj KEK nga KÇPB,(HPD), kishte kërkuar të mos i njihet palës përgjegjëse e drejta pronësore në këtë banesë, sepse i njëjti kishte banesën tjetër. Po ashtu me kërkesën e sekretarisë së AKP-së, KEK-u, me datë 18.08.2010, kishte dhënë përgjigje në kërkesën e palës ankuese, duke theksuar se Vendimi për ndarje të banesës palës ankuese H. Q., ishte i karakterit të përkohshëm dhe ky dokument nuk ekziston në arkivin e tyre, ndërsa palës përgjegjëse i ishte ndarë kjo pronë në mënyrë të ligjshme.
9. Sekretaria e AKP-së kishte gjetur *ex officio* se pala përgjegjëse në ankesë Z. G. kishte paraqitur kërkesë të kategorisë C, në Drejtorinë për Çështje Pronësore Banësore,(HPD), për pronën e njëjtë, e cila ishte kontestuar nga pala ankuese. Me Vendimin HPCC/D/.../2003/C, të dt. 12.12.2003, ishte miratuar kërkesa e tij për ri posedimin e banesës kontestuese. Ndërsa me Vendimin për rishqyrtim HPCC/REC/.../2006, të dt. 18.10.2006, komisioni e kishte refuzuar kërkesën (ankesën), e palës ankuese H. Q. dhe palës së tretë KEK-ut, për rishqyrtimin e vendimit të shkallës së parë.
10. Ky vendim përfundimtar i KÇPB, konfirmonte vetëm të drejtën e posedimit dhe ri posedimit, andaj ky Vendim nuk konsiderohet *Res Judicata* në procedurën në AKP, sepse pala ankuese me kërkesën e tij nga AKP kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore në pronën e kërkuar.
11. Me datë 21 Tetor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës, me vendimin KPCC/D/R/263/2014, vendosi që kërkesa e palës ankuese të refuzohet. Sipas arsyetimit të dhënë në paragrafët 38-40, theksohet se, “paraqitësi i kërkesës të drejtën e tij për konfirmimin e të drejtës pronësore e bazon në Vendimin për ndarje të lëshuar nga KEK- në vitin 1992, i cili vendim nuk ka mundur të verifikohet nga sekretaria ekzekutive si i vërtet, paraqitësi i kërkesës ka ofruar edhe disa fatura të shërbimeve publike në lidhje me pronën e kërkuar që e provon se ka qen duke e shfrytëzuar para konfliktit, por që në mungesë të ndonjë dëshmie tjetër konfirmuese, faturat nuk përbëjnë prova të mjaftueshme për konfirmimin e të drejtës pronësore. Po ashtu Komisioni vëren se pala ankuese nuk i ka përmbushur kushtet e ndarjes në shfrytëzim të pronës kontestuese nga bartësi kompetent i të drejtës së ndarjes, duke lidhë kontratë shfrytëzimi të banesës dhe duke e marrë banesën

në posedim ashtu si parashihet me Ligjin mbi Mardhënjët Banesore (42/86), i ndryshuar me Ligjin për Banim (50/92).

12. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese, me datë, 21/01/2015. Më 19/02/ 2015, për mes postës rekomande, pala ankuese për mes të autorizuarit avokat B. Sh., ka paraqitur ankesë kundër këtij Vendimi në Gjykatën Supreme dhe plotësim ankese 07.09.2017.
13. I Autorizuari i palës përgjegjëse në ankesë, Z. G., av. Z. K., e ka pranuar Vendimin e KKKP-së, me datë 30.12.2014.
14. I autorizuari i palës përgjegjëse në ankesë, av. Z.K., ankesën e palës ankuese e ka pranuar me datë 28.01.2016. Me datë 09.02.2016, brenda afatit ligjor prej 30 ditë, ka paraqit përgjigje në ankesën e tij.

Pretendimet e palës ankuese

15. Pala ankuese thekson se Vendimi i KKKP-së, përmban shkelje thelbësore të së drejtës materiale dhe procedurale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
16. Pala ankuese, pasi e bënë përshtkrimin e vendimit të ankimuar, thekson ndër të tjera se; i njëjti është jo ligjor sepse nuk i ka analizuar faktet e theksuara nga ky si ushtrues i kërkesës, se arsyetimi është i formuar në gjininë femërore , këtij vendimi i mungojnë faktet dhe analizimi i tyre si dhe arsyetimi adekuat, se komisioni i ka marrë për bazë vetëm provat e paraqitura nga pala përgjegjëse të cilat janë jo të vërteta dhe i tërë dokumentacioni i ofruar nga ai është i falsifikuar që dëshmohet nga raporti i veçantë drejtuar prokurorisë, ndërsa i njëjti ka qen në posedim të një banese tjetër në lagjen Dardania, se gjykata për këtë banesë ka nxjerrë vendimin në bazë të kërkesës së KEK, për ndalimin e shitjes së tij, se ushtruesi i kësaj ankese e ka të drejtën në këtë banesë në bazë të vendimit për ndarje të përkohshme nga KEK-u, dhe po ashtu në bazë të Ligjit për. Mardh. Banesore, i takon e drejta në shfrytëzimin e banesës sepse e ka pas në shfrytëzim prej vitit 1992, në te ka jetuar mbi pesë vite pa ndërprerë ashtu si parashihet me këtë ligj, etj.
17. Në fund pala ankuese propozon që Gjykata Supreme ta aprovoj si të bazuar ankesën dhe të vendoset i në propozimin e tij që palës ankuese ti njihet e drejta në banesën lëndore ,të prishet vendimi i KKKP-së, dhe lënda të kthehet në rivendosje ose i njëjti të ndryshohet dhe të aprovohet kërkesa e tij KPA01404.
18. Në plotësim ankese thekson se Prokuroria Themelore Prishtinë -departamenti për krime të rënda ka zhvilluar hetime lidhur me banesën lëndore dhe dokumentacionin e paraqitur nga pala përgjegjëse si dhe hetime ndaj personave zyrtar të AKP-së, që i kanë vlerësuar si të

rregullta dhe janë bazuar në këto dokumente dhe në bazë të tyre komisioni e ka nxjerrë vendimin e ankimuar.

Pretendimet e palës përgjegjëse në ankesë

19. Përfaqësuesi i palës përgjegjëse në ankesë avokat Z. K., në përgjigjen në ankesë të palës ankuese ndër të tjera thekson se; janë të pa bazuara pretendimet e të autorizuarit palës ankuese si në ankesën e ushtruar sepse vendimi i KKPK-së, nuk është i përfshirë me shkeljet e pretenduara ankimore ndërsa nuk janë të qëndrueshme theksimet se palës ankuese, H.

Qafleshi i është ndarë banesa lëndore nga KEK-u, ndërsa prova të cilën e ofron Vendimin për ndarjen e banesës nr. ... e dt. 10.03.1992, është duke u zhvilluar procedurë penale si dëshmi e falsifikuar, se pala përgjegjëse Z. G. është pronar legjitim i banesës lëndore e cila ishte ndarë në shfrytëzim e të cilën tani e ka blerë, në bazë të kontratës të lidhur me KEK nr...., dt.03.06.2015, dhe Kontratës së noterizuar për shitje me KEK nr. Rend. ..., nr. ref. ..., dt. 04.06.2015, dhe tani kjo banesë është e regjistruar në emër të tij, (provë ,Certifikata e pronës, nr. ..., e dt.27.07.2015),etj.

20. Në fund propozon që ankesa e palës ankuese të hedhet poshtë si e pa lejuar ndërsa vendimi përfundimtar i komisionit të vërtetohet.

Arsyetimi ligjor;

Pranueshëria e ankesës

21. Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi ankesën, në përputhje me nenin 12 dhe 13 të Rregullores së UNMIK 2006/50, e ndryshuar me ligjin nr.03/L-079, dhe nenin 194 të LPK-së, dhe gjen se Ankesa është e pranueshme dhe e afatshme e paraqitur brenda afatit prej 30 ditë, ashtu siç është përcaktuar me nenin 12.1, të Ligjit nr. 03/L-079.

Meritat e ankesës

22. Nga përmbajtja e Vendimit të KKPK, pretendimeve të palës ankuese, përgjigjes në ankesë si dhe shkresave të tjera të lëndës, pa dyshim vërtetohet se, prona e kërkuar-banesa , nuk ishte pronë private por ishte pronë shoqërore-publike, ndërsa pronar ishte Korporata Energjetike e Kosovës, (KEK) me seli në rr. “Nëna Terezë”, nr. 36, Prishtinë. E njëjta banesë asnjëherë nuk ishte privatizuar nga shfrytëzuesit e saj ashtu si parashihej me ligj. Pala ankuese i cili pretendon të drejtë pronësore në këtë pronë, në AKP, dhe as tani në ankesë nuk ofron asnjë provë që kjo pronë është privatizuar ndonjë herë apo se e njëjta duhet të trajtohet si pronë private.

23. Bazuar në dokumentet në shkresat e lëndës çështja ka të bëjë me shfrytëzimin e banesës nga pala ankuese, apo edhe nga pala përgjegjëse sipas kontratës së lidhur në mes të dhënësit të banesës, KEK dhe shfrytëzuesit të banesës.
24. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë të zgjidhë kërkesat që kanë të bëjnë me të drejtën e pronësisë mbi pronën **private** dhe kërkesat që kanë të bëjnë me të drejtën e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme **private**.
25. Për më tepër sipas nenit 2.1 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 mbi implementimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerçiale, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, në tekstin e mëtejme Urdhëresa Administrative (UA) “çdo person që ka pasur të drejtën pronësore, posedimin e ligjshëm **apo çfarëdo të drejte të ligjshme në pronë të paluajtshme private**, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, i cili në kohën e parashtrimit të kërkesës nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij pronësore për shkak të rrethanave drejtpërdrejt të lidhura me konfliktin e armatosur të vitit 1998/1999, apo rrethanave që kanë rezultuar nga ai, ka të drejtë në rikthimin e së drejtës së tij në pronë, në cilësinë e poseduesit të së drejtës në pronë”.
26. KKPK-ja ka tejkalluar kompetencat kur kishte shqyrtuar dhe vendosur në mënyrë meritore si në vendimin e ankimuar duke e refuzuar kërkesën e palës ankuese në mungesë të dokumentacionit të vlefshëm juridik për shfrytëzimin e banesës lëndore. KKPK, është dashtë ta hedhë kërkesën e palës ankuese duke u bazuar në nenin 11.4,(a), të Ligjit nr.03/L-079, sepse banesa lëndore nuk kishte qen pronë e pa luajtshme private e asnjërës palë dhe duke qen kështu është jashtë juridiksionit dhe fushë veprimit të aplikimit të procedurës para AKP-së.
27. Vërtetimi dhe mbrojtja e të drejtave të shfrytëzimit mbi pronat banesore në pronësi shoqërore dhe/ose pronat publike nuk bie në kuadër të juridiksionit të KKPK-së, respektivisht të Kolegjit të gjykatës supreme. Kjo çështje është e rregulluar me Ligjin nr. 04/l-061, për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore që ka hyrë në fuqi me date 27 Janar 2012 ,dhe Ligji nr. 04/l -247, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore i cili ka hyrë në fuqi me 14 Maj 2014.
28. Theksimet në ankesë dhe plotësim ankese, se pala përgjegjëse është shërbyer me dokumente të falsifikuara, ndërsa në mënyrë të njëjtë akuzohet edhe pala ankuese nga pala përgjegjëse në ankesë, se pala ankuese ka falsifikuar kontratën e lidhur për shfrytëzimin e banesës, kolegji këto pretendime të ndërsjella i vlerëson se nuk janë me peshë apo me ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje, sepse mënyra e vendosjes sipas ankesës nga kolegji të çështjes lëndore materiale, nuk bazohet në dokumentet të cilat nga palët pretendohet se nuk janë të vërteta, e në bazë të cilave u është njohtë vetëm e drejta e shfrytëzimit të banesës por

jo e pronësisë. Vlerësimi i vlefshmërisë së dokumenteve të kontestueshme si jo autentike nga palët ,megjithatë bie jashtë juridiksionit të KKPK-së, apo Gjykatës Supreme.

29. Andaj nga kjo gjendje faktike e çështjes lëndore, Gjykata Supreme gjen se vendimi i KKPK-së, si i tillë është i pa qëndrueshëm prandaj anulohet, jo për merita të ankesës në drejtim të njohjes së të drejtës së palës ankuese, por me rastin e ankesës së palës, *ex officio*, si në kuptim të nenit 198.1, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili ligj zbatohet *mutatis mutandis* në procedurën e kolegjit të Gjykatës Supreme dhe gjykata e hedhë poshtë kërkesën e tij, në kuptim të nenit 11.4 (a), Rregullores së UNMIK nr.2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr.03/L-079, për mungesë juridiksioni të Komisionit për Kërkesa Pronësore Juridike. Nga këto arsye Gjykata Supreme nuk mori në shqyrtim të mëtejme meritat e ankesës.
30. Ky aktgjykim nuk paragjykon të drejtë pronësore të palëve në procedurë në pronën lëndore dhe nuk paraqet pengesë për iniciimin e procedurës pran organit apo gjykatës kompetente, nga secili, nëse e vlerësojnë të nevojshme dhe me interes ligjor.
31. Në bazë të asaj që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 11.4, a), dhe 12.2 të Rregullores së UNMIK, nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin, nr. 03/L-079 dhe nenin 198.1 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
GSK-KPA-A-02-2016, me datë 21 Mars 2019

Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Beshir Islami